

REPUBLIKA E KOSOVES REPUBLICA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA - VLADA - GOVERNMENT
MINISTRIA E EKONOMISE DHE AMBIENTIT
MINISTRATVO EKONOMIJE I ZIVOTNE SREDINE
MINISTRY OF ECONOMY AND ENVIRONMENT

Nr./ Br. / No _____
Nr. i faq/ Br. str. No.pg 3608/20
Data/ Datum : Date / / 02
Prishtinë-Prishtina-Pristina Nr.II 06.08.20



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Životne Sredine
Ministry of Economy and Environment

Kabineti i Ministrat/Kabinet Ministra /Kabinet of the Minister

Nr. 106
Data: 05/08/2020

Ministri i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit, duke u bazuar në nenin 93 paragrafi 4, të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, nenin 10 të Ligjit Nr.06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura (Gazeta Zyrtare, Nr.7, 01 Mars 2019), nenin 8 paragrafi 1.4. të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, të ndryshuar dhe plotësuar nga Rregullorja Nr. 07/2020 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, si dhe nenin 21 paragrafin 2 të Ligjit Nr.06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje (Gazeta Zyrtare, Nr. 14, 20 Gusht 2018), nxjerr:

V E N D I M

- I. Vazhdohet afati për dorëzimin e aplikacioneve për legalizimin e ndërtimeve pa leje sipas nenit 21 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje.
- II. Afati për dorëzimin e aplikacioneve nga paragrafi 1 i këtij Vendimi, vazhdohet për herë të parë në afat prej dymbëdhjetë (12) muajve deri më datë 04 shtator 2021.
- III. Ky vendim nxirret duke marr në konsideratë nevojën për kohë shtesë, për të arritur qëllimin e Ligjit Nr. 06/L-024 për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje si dhe duke marr për bazë mungesën e kapaciteteve të komunave në zbatimin e ligjit si dhe rrethanat e krijuara gjatë kohës së pandemisë.

IV. Vendimi hyn në fuqi më datë 05 shtator 2020.

Blerim Kuci

Ministër i Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit

Vendimi t'i dërgohet;

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Kryetarëve të Komunave të Republikës së Kosovës;
- Drejtorive të Urbanizimit të Komunave;
- Zyrave Komunale Kadastrale të Komunave;
- Agjencisë Kadastrale të Kosovës
- Departamentit për Planifikim Hapësinorë, Ndërtimit dhe Banimit;
- Departamentit Ligjor;
- Arkivit të MEA-së.